



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1377 Prot.

Tiranë, më datë 15.09.2021

VENDIM
Nr. 562, datë 15.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.09.2021:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rindërtim dhe shtesë kati në objekt ekzitues dhe ndërtim i ri, me funksion hoteleri “La Belle Epoque”, Pogradec”, brenda kufirit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit, me aplikues z. Loran Bellani, projektues restaurator z. Genci Samimi dhe zhvillues z. Edlir Piliçi;
 - Të bëhet një studim më i thelluar duke u bazuar në VKM Nr. 554, datë 18.06.2015 “Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj”, Neni 4, Pika 3 dhe Pika 4;
 - Të risillet projekti me një propozim të ri për trajtimin e fasadave.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

